

# Duke përkrahur fëmijët e vegjël të hyjnë në botën e shkrim-këndimit

Të dashur prindër, gjyshe, gjyshër dhe kujdestarë fëmijësh të vegjël!

Fëmija juaj fillon rrugën e tij shkollorë dhe dëshira e të gjithëve është që kjo udhë t'i japë shumë gëzime, shumë suksese të mëdha e të vogla dhe ta pajisë me të gjitha dijet, aftësitë dhe zotësitë që janë të nevojshme si për ecurinë e tij shkollorë ashtu dhe për jetën e tij në vazhdim si i rritur.

Vend kryesor, midis dijeve dhe aftësive që duam të fitojë çdo fëmijë gjatë jetës së tij shkollorë, zënë edhe ato që lidhen me shkrimin.

Mësoj rreth  
fëmijës

*Çfarë mund të bëni si të rritur në ambientin familjar për të lehtësuar fillimet e fëmijës në shkrim?*

Përderisa fëmija juaj filloi udhën e tij shkollorë, çdo njohuri e juaja në shkrim-këndim, çdo gjuhë që flisni, **JU NDIHMON QË T'I OFRONI NDIHMË TË RËNDËSISHME!**

Në studime të posaçme që janë kryer vitet e fundit është vërtetuar se bisedat që bëhen lirshëm me fëmijët, gjatë studimit të tyre rreth botës, i ndihmojnë të organizojnë më mirë të folurit e tyre dhe luajnë rol të rëndësishëm në përgatitjen e tyre për lexim e shkrim. Për këtë është e rëndësishme të:

- Bisedoni me fëmijët tuaj lidhur me ç'shikoni kur ecni në rrugë, kur jeni në autobus ose në tren dhe ta komentoni atë. Këto biseda e ndihmojnë t'i bëjë më të rregullta përshkrimet dhe të pasurojë fjalorin e tij.

**VËZHGONI BASHKË  
ME FËMIJËT TUAJ  
BOTËN DHE  
BASHKËBISEDONI  
RRETH SAJ!**

- Kërkoni nga fëmija juaj t'ju tregojë për çfarë ka parë apo ka ndodhur atje ku shkoi pa ju: tek shoku i tij, në shkollë, në parkun e lojrave... I bëni pyetje për gjithçka keni të paqartë apo për gjithçka doni të mësoni, duke i treguar interesimin tuaj dhe duke i lejuar të mos përgjigjet për çfarë nuk do. Bisedat duhet të jenë të lirshme dhe të mos kenë fare karakter kontrollues. Janë të rëndësishme sepse kultivojnë aftësinë e të treguarit. Që të arrijnë qëllimin e tyre fëmija duhet të marrë pjesë me kënaqësi në to dhe t'i kërkojë vazhdimisht.



Shumë e rëndësishme në zotërimin e të shkruarit është të ndihmoni fëmijën të kuptojë se leximi dhe shkrimi do t'a lejojnë të bëjë gjëra që i pëlqejnë dhe që i interesojnë dhe që nuk mund t'i bëjë n.q.s nuk di të shkruajë dhe të lexojë.

## **JEPINI FËMIJËS SUAJ MOTIVACIONE PËR TË LEXUAR E SHKRUAR!**

Disa nga këto gjëra janë:

- të dijë kur jepen në televizor emisionet e tij të dashur,
- të lexojë përrallat e tij të dashura,
- të lexojë udhëzimet e lojrave të tavolinës ose të montimit të lodrave të tjera që i pëlqejnë,
- të shënojë ato që ka dëshirë në mënyrë që t'ua kujtojë juve apo që ai vetë të mos i harrojë,
- t'i shkruajë letra gjyshes, gjyshit ose shokëve të tij që janë larg,
- të shkruajë sekretet e tij,
- dhe shumë të tjera....

Të gjitha këto i vështirësojnë fëmijët e vegjël që t'i kuptojnë kur thjesht vetëm ua themi. I kuptojnë shumë më mirë kur i përjetojnë në praktikë dhe pastaj funksionojnë si motive për të mësuar të shkruajnë dhe të lexojnë. Që të ndihmoni fëmijën të kuptojë të mësipërmet ju propozojmë:

- të këshilloni me të programet televizive duke e ndihmuar të zbulojë emisionet që i pëlqejnë,
- ta merrni me vete kur shkoni për të blerë gazetën dhe disa herë t'i sygjeroni të zgjedhë dhe të blejë një revistë fëminore,
- të kërkonti bashkëpunimin dhe ndihmën e tij me qëllim që të shënoni ato që doni të blini në çdo dalje në treg që të mos e harroni,
- të krijoni një bllok shënimesh në kuzhinë ku do të shënoni ato që ju nevojiten dhe t'i kërkonti të kontribuojë duke shënuar dhe ai vetë si të mundet kur i kujtohet diçka,
- ta merrni me vete në treg dhe t'i kërkonti ndihmë që të gjeni produktet që doni të blini, p.sh. në raftet e supermarketit,
- nëse është e thjeshtë të mbani përpara tij shënime kalendarike në çdo lloj gjuhe që njihni në mënyrë spontane dhe natyrisht t'i shpjegoni se shkruani në të ato gjëra që keni dëshirë dhe që nuk doni t'i harroni,
- të hapni para tij çdo letër që arrin në shtëpi,
- të kërkonti pjesëmarrjen e tij kur i shkruani një letër një shoku apo një të afërmi që është larg,

**DHE KRYESISHT**

**T'U LEXONI SHPESH FËMIJËVE TUAJ DHE BASHKË ME TA  
LIBRA PËR FËMIJË!!!**

### ***T'i lexoni fëmijës suaj libra me zë të lartë!***

Leximi me zë të lartë nga të rriturit është tërheqës për fëmijët e vegjël, 'bën të gjallë' historinë që u lexoni dhe protagonistët e saj! Gjatë leximit fëmijët vijnë në kontakt jo vetëm me përmbajtjen, por dhe me strukturën dhe organizimin e gjuhës së shkruar dhe përfitojnë njohuri që u janë të vlefshme në vazhdimësi...

Dhe sigurisht fitojnë motivacione, përderisa kuptojnë sa mirë mund të kalojë dikush me një libër, nëse sigurisht kaloni dhe ju mirë me të!

---

### ***T'i lexoni fëmijës suaj rregullisht libra!***

Mos hezitoni t'i lexoni libra në gjuhën tuaj, nëse fëmija studion në një shkollë ku gjuha zyrtare është tjetër nga ajo e juaja. Karakteristikat e gjuhës së shkruar mundet që dikush t'i kuptojë në çdo gjuhë. Gjithashtu është tashmë e njohur se kur fëmijët kanë 'ndërtuar' struktura të forta në gjuhën e tyre amtare, mund të mësojnë më mirë dhe çdo gjuhë tjetër. Mos hezitoni t'ju lexoni, edhe nëse ju nuk jeni lexues apo lexuese e rregullt. Fëmija juaj nuk do t'ju gjykojë! Përkundrazi është shumë e rëndësishme të ndani bashkë me të leximin! T'i përgjigjeni kërkesës së fëmijës suaj sa herë ju kërkon që t'i lexoni të njëjtin libër. Përsëritja e ndihmon të kuptojë shumë gjëra si në lidhje me përmbajtjen ashtu dhe në lidhje me strukturën e librit.

### ***Praktika të tjera të preferuara leximi...***

Gjatë leximit, lejojini fëmijës suaj t'ju ndërpresë, t'ju pyesë apo të komentojë në bazë të diçkaje që di, që ka dëgjuar ose që ka parë në televizor, të bëjë supozime për vazhdimin ose fundin e historisë, të gjejë dhe të komentojë çfarë të dhënash të tjera japin figurat që nuk i jep teksti. Ky bashkëveprim e tij me tekstin dhe ilustrimin figurativ favorizon zhvillimin e marrëdhënieve të tij me librin fëmijor dhe si rrjedhim me gjuhën e shkruar.

Krijoni bashkë me të 'praktika' për leximet tuaja. Një orë të caktuar të ditës, një vend të caktuar në shtëpi...

Një zakon i mirë është ajo e leximit të përrallave para gjumit. Sado të lodhur të jeni, duhet të jetoni me fëmijën tuaj një çast të vetëm që do të mbetet pozitiv në kujtesën e tij për shumë, shumë vjet!

---

### ***Në vazhdim të leximit ose të shpjegimit të librit,***

pyeteni fëmijën tuaj çfarë i pëlqeu ose çfarë nuk i pëlqeu dhe mos hezitoni të përmendni çfarë u pëlqeu apo çfarë nuk iu pëlqeu juve...

---

### ***Zakone të tjera lexuesish...***

Ndihmoni fëmijën tuaj të fitojë zakone lexuesi, siç:

- të marrë me vete ndonjë libër të dashur, nëse rastis të mungojë disa ditë nga shtëpia,
- të ketë përkrah krevatit të tij librat që i pëlqejnë të shfletojë para se të flerë në darkë...



## ***Të shpjegoni sëbashku me fëmijët tuaj librat që u jepen hua nga biblioteka e shkollës dhe t'u inkurajoni këto mënyra huazimi!***

Mund të shpjegoni sëbashku librat që huazuan fëmijët tuaj, edhe pse nuk e njihni gjuhën me të cilën janë shkruar. Shikoni dhe komentoni bashkë me fëmijët tuaj figurat, supozoni çfarë mund të thotë teksti, u kërkoni t'ju thonë nëse e lexuan këtë libër në shkollë dhe çfarë thoshte, t'ju thonë, nëse u kujtohet, si quheshin në greqisht titulli ose/dhe heronjtë e historisë, u kërkoni të verifikojnë supozimet që bëtë ditën tjetër në klasë dhe t'ua thonë, u thoni nëse keni libra përkatësisht me të njëjtit heronj në gjuhën tuaj e.t.j... Një CD player mund të jetë një ndihmës i vlefshëm! Kërkoni nga mësuesja, nëse është bashkëpunuese, t'u huazojë fëmijëve tuaj libra që shoqërohen me CD, të cilët do të mund të dëgjoni bashkë me fëmijët tuaj që të mësoni dhe ju greqisht!

## ***Gjeni kohën të vizitoni me fëmijën tuaj një bibliotekë me libra për fëmijë.***

Komentoni bashkë me të pasurinë e librave që do të gjeni atje dhe inkurajoni që të zgjedhë atë apo ata që do t'i pëlqenin të huazojë.

Kërkoni të vizitoni bashkë me fëmijën tuaj librarinë, me qëllim që të blini librin – dhuratë për festën apo ditëlindjen e shokut apo të shoqes së tij.

Bisedoni me të kriteret e zgjedhjes. Cilin libër do të zgjidhte për shokun apo shoqen e tij? Pse beson se ky libër do t'i pëlqejë shokut apo shoqes së tij?

## **AKTIVITETE TË TJERA**

Hyni me fëmijën tuaj në një lojë, duke i sygjerruar të gjeni të shkruarat që janë në shtëpi ose në rrugë, p.sh. gjatë rrugës nga shkolla në shtëpi. Kush gjen më shumë fiton! Bisedoni për çfarë shërben çdo shkrim në atë vend, etj.

Luan me fëmijën tuaj lojra tavoline me gërma dhe fjalë.

Bisedoni dhe komentoni me fëmijën tuaj kur shikon filmat e tij të dashur në televizor, si dhe synimet dhe veprimet e heronjve, bëni me të supozime lidhur me zhvillimin e historisë...

Inkurajoni fëmijën tuaj të shohë filma në gjuhën greke dhe bashkëbisedoni me fëmijën tuaj ose/dhe i kërkoni t'ju shpjegojë çdo gjë që nuk kuptoni, duke komentuar si më lart...



Enti zbatues

**POLIDHROMOS:** Grupi dhe Botimi periodik për Dygjuhësinë dhe Shumëkulturrën në Arsimit dhe në Shoqëri

Autore teksti

**Hara Dhafermu,** Lektore në Departamentin i Arsimit të Moshave Parashkollore

Koordinatorë të programit

**Birbili Maria – Cokalidhu Rula**

Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe të Arsimit Parashkollor, Universiteti Aristoteli Selanik

Website: [www.polydromo.gr/dialogos](http://www.polydromo.gr/dialogos)

Përkthyes: **Valbona Hystuna / Përpunuan tekstin: Evi Marku**

[www.polydromo.gr](http://www.polydromo.gr)  
[polydromo@polydromo.gr](mailto:polydromo@polydromo.gr)

Me mbështetjen e

